

Ne perputhje me Nenin 28, paragrafi 3-te te Ligjit 97/2007, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:

AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GREEN BUSINESS INVEST ‘SH.P. K

Sot, me, date 15 Tetor,2025 pala e meposhtme:

Z. Devis Bano, shtetas shqiptar, atesia Thanas dhe amesia Ermioni, lindur ne Berat me 21, Gusht,1977 banues ne Tirane, ne adresen Eduard Mano Nd 26, 1044 Tirane, me zotesi te plote per vepruar, mbajtes I kartes se Identitetit me Nr. H70821050R.

KAPITULLI 1
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

1.1 Shoqeria **“Green Business Invest”** Sh.p.k (ne vijim Shoqeria) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.

1.2 Shoqeria vepron sipas Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

1.3 Akti I Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar, qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emertimi

2.1 Emertimi I shoqerise eshte **“Green Business Invest “SH.P. K**



Neni 3- Objekti I Shoqerise

3.1 Objekti I shoqerise eshte:

Prodhim, përpunim, grumbullim dhe tregtim të produkteve bujqësore, pyjore, zhvillim i fermave bujqësore; kultivim i bimëve medicinale, drufrutore, vreshta, dhe kultura të tjera bujqësore; ndërtim dhe administrim serash, magazinash, linjash përpunimi dhe qendrash grumbullimi; import-eksport i produkteve bujqësore dhe inputeve të prodhimit (fara, plehra, pesticide, pajisje, makineri, etj).

Projektim, zhvillim dhe ndërtim objektesh civile, industriale, bujqësore dhe turistike; rikonstruksione, restaurime dhe punime të ndryshme infrastrukturore; ofrim shërbimesh inxhinierike dhe menaxhim projektesh ndërtimi.

Blerje, shitje, zhvillim, ndarje dhe dhënie me qira të pasurive të paluajtshme; ndërtime rezidenciale, komerciale dhe industriale për qëllime fitimi; menaxhim dhe mirëmbajtje objektesh banimi, biznesi apo turizmi; ndërmjetësim në transaksione imobiliare.

Ndërtim, zhvillim dhe administrim strukturash akomoduese si hotele, resorte, vila turistike, agroturizëm, qendra wellness dhe spa; ofrim shërbimesh të ushqimit, rekreacionit, eventeve, udhëzimit turistik dhe promovimit kulturor e natyror; organizim aktiviteteve turistike dhe promovim të turizmit të qëndrueshëm.

Investime, ndërtim dhe operim impiantesh për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme (diellore, eolike, ujore, biomase); tregtim pajisjesh energjetike

Shoqëria mund të zhvillojë çdo veprimtari tjetër të ligjshme që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj kryesor, si dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 4-Selia

4.1 Selia e shoqerise Rruga Faik Konica Tirane ZK8160 Ap 15.

4.2 Transferimi I selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me Vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem/Ortakeve.



4.3 Asambleja e Ortakut te vetem/Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve , degeve dhe perfaqesive te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

Neni 5- Kohezgjatja e veprimtarise

5.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.

5.2 Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati ose mund te ndryshoje kohezgjatjen e saj me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem/Ortakeve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6- Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar I shoqerise eshte 1,000 (nje mije) Leke.

6.2 Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote e gjitha e nenshkruar dhe e shlyer , me vlere nominale 1,000 (nje mije Leke).

Neni 7 – Kontributet

7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:


- **Z. Devis Bano** ka ofruar nje kontribut te barabarte me 1,000 (nje mije Leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.

7.2 Sipas kontributeve te mesiperme:

- **Z. Devis Bano** zoteron 1 (nje) Kuote qe I korespondon 100% (njqind perqind) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakut te vetem/Ortakeve.



8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogelimi I kapitalit themeltar

9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem/Ortakeve. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufinjte e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogelimi I kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 10- Transferimi I Kuotave

10.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

10.2 Ne rast transferimi ne cdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim ne kuptimin me te gjere te fjales, duke perfshire ketu edhe dhurimin ne favor te subjekteve te tjera te ndryshem nga ortaket , kuotat duhen me pare ti ofrohen per parablerje ortakeve te tjere.

10.3 Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje kuoten e tij duhet te njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin per shitje, duke percaktuar cmimin , kushtet, modalitetet, emrin e blerersit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet ti referohet te gjitha kuotave te ofruara per shitje.

10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 15 (pesembedhjete) dite nga marrja e letres rekomande, per ti komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejten mase me kuotat qe ata zoterojne, pervec rasti kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast pranuesi I ofertes nuk mund te ushtrojte pjeserisht te drejten e parablerjes.

10.6 Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund tu transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin pozitiv te Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve.



10.7 Ne rast te transferimit te kuotave per shkak trashegimie *mortis causa* ortakët e tjere kane te drejte te shprehin pelqimin e tyre per ortakët e rinj. Ne rast se nuk jepet pelqimi kuotat mund tu transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht me vendimin pozitiv te asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve te shoqerise.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11- Asambleja e Ortakeve dhe kompetencat e saj.

11.1 Organi vendim-marres I Shoqerise eshte Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve.

11.2 Asambleja e Ortakut te Vetem/ Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per ceshtjet vijuese:

- Ndryshimet e Statutit
- Emerimi dhe Shkarkimi I Administratoreve, eksperteve kontabel,likuidatoreve.
- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit
- Transferimi I kuotave
- Shperndarja e fitimit
- Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- Miratimi I bilanceve te shoqerise
- Cdo veprim tjeter parashikuar nga ky Statut apo Legjislacioni perkates.

Neni 12- E drejta e pjesemarrjes dhe e votes.

12.1 Cdo ortak ka te drejte te mare pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri I kuotave qe ai zoteron.



12.2 Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, I pajisur me prokure me shkrim , me ane te se ciles mund te jape voten e tij.

12.3 Ortaku mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kalitalit qe zoteron, neqoftese voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 13- Thirrja e Asamblese se Ortakut te Vetem/ Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve, thirret te pakten 1 (nje) here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit , te raportit te Administratorit , ekspertit kontabel si dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej Administratoreve si dhe nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar . Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet tu dergohet ortakeve ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve dhe ekspertit kontabel , nese eshte emeruar, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te mbase informacion mbi llojin e Asamblese, ceshtjet qe do te trajtohen ne Asamble per te cilat do te meret vendim mbi vendin , daten dhe oren e thirrjes se pare dhe te dyte.

13.3 Asambleja mund te thirret dhe jashte Selise se Shoqerise, brenda apo jashte Republikes se Shqiperise.

13.4 Ne rast se Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve nuk mblidhet me thirrjen e pare per mungesen e kuorunit te parashikuar ne piken 13.7 te ketij Statuti , Asambleja e ortakeve do te mblidhet brenda 30 (tridhjete) diteve me te njejtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjitha pjesemarresit te mund te identifikohen dhe tu lejohet atyre qe ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te ceshtjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes. Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet dhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do te thirret dhe do te mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit,ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.



13.7 Vendimet e Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë përqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve qe kerkojne nje shumice te cilesuar , jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 51% (pesëdhjetë e një përqind) te kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve vendos ndryshimet e Statutit, emerimet e Administratoreve dhe ekspertit kontabel si dhe shkarkimet, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve , riorganizimin dhe prishjen e shoqerise me voten pro te $\frac{3}{4}$ (tret e katërtat) e ortakeve te pranishem qe zoterojne te pakten 51% (pesëdhjetë e një përqind) te kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet e tjera Asambleja merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve qe zoterojne te pakten 30% (tridhjetë përqind) te kapitalit themeltar.

13.9 Cdo Asamble drejtohet nga nje ortak apo nga ndonje person tjetër I caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron nje sekretar , qe mund te jete edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari I Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 14- Administrimi

14.1 Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator I cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh.

Administratori I pare I Shoqerise eshte emeruar **Z.Devis Bano**, atesia Thanas, amesia Ermioni, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane ne rrugen Eduard Mano 1044 Tirane. mbajtes I pashaportes me numer **BB8382432** dhe me numer personal **H70821050R**.

14.2 Perfaqesimi ligjor I shoqerise I besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroje te gjitha fuqite konform mesa parashikohet ne Nenin 95 te ligjit 9901te dates 14.04.2008 per Tregtare dhe shoqerite Tregtare.

14.3 Administratoret mund te emerojne perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

Neni 15- Eksperti Kontabel I Autorizuar

15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve, kontrolli I bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise mund ti besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.



51.2 Eksperti kontabel I miratuar mund te shkarkohet sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16- Viti financiar dhe bilanci vjetor

16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te secilit vit.

16.2 Viti I pare financiar fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.

16.3 Bilancet Vjetore, Inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligji n 9901 te dates 14.04.2008 per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

16.4 Miratimi I dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi I vitit financiar .

Neni 17- Fitimet

17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.


17.2 Asambleja mund te vendose dhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve plotesisht ose pjeserisht per vitet financiare te ardheshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 18- Prishja

18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji ose me ane te nje vendimi te asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.



18.2 Shoqeria nuk prishte ne rast humbjes se zotesise per te vepruar , vdekjes , ose falimentimit te ortakeve.

Neni 19- Likuidimi

19.1 Ne rast prishje shoqeria duhet te likujdohet

19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise , mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojeshme per te perfunduar likuidimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do ti shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit te ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20- Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

20.1 Te gjitha mosmarrevshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe akti te themelimit, si dhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shqiperise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise , do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet paleve te interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarrveshjes, ato do ti besohen Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21 - Gjuha

21.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen Shqipe.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“GREEN BUSINESS INVEST” SH.P. K

DEVIS BANO

DEVIS BANO

